



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.66/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi, në konfliktin administrativ, të paditësit “E...” Sh.P.K. me seli në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.E Avokat në Prishtinë, kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike - anulim vendimi, objekt kontesti - rivlerësim malli, vlerë kontesti 16,074.02 EUR në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor publik të mbajtur, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit B.E Avokat dhe të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur M.K me datë 26.09.2022 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “E...” Sh.P.K. me seli në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.E Avokat në Prishtinë, si e bazuar.
- II. ANULOHET vendimi nr. 01.3.2.2/9300 i datës 27.08.2020 i Doganës së Kosovës dhe lënda KTHEHET NË RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A R S Y E T I M

Paditësi “E...” Sh.P.K. me seli në Prizren, me padinë e paraqitur në Gjykatë përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokat B.E, me datë 30.09.2020, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën i ka propozuar gjykatës të aprovet ankesa/padia si e bazuar, të anulohet aktvendimi 01.3.2.2/9300 i datës 27.08.2020 dhe të detyrohet e paditura Dogana e Kosovës që paditësit t’ia pranoj vlerën e mallit të prezantuar në dokumentin unik doganor me kamatë ligjore 8% nga data kur mjetet janë paguar si rezultat i rivlerësimit të paligjshëm. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaroi se gjithashtu, pas administrimit të provave do të vërtetohet se pala paditëse ka paguar vlerën 16,074.02 € më shumë se sa vlera e cila është dashur të paguhet nga pala paditëse gjatë zhdoganimit të mallit, gjithmonë duke u bazuar në vlerën reale të mallit dhe pagesave, ashtu siç parashihet me KDAK, andaj, me këtë edhe bëjë precizimin e padisë, kështu që petitumit të kësaj padie në paragrafin III precizohet ashtu që: Dogana e Kosovës obligohet që këtu paditësit t’ia kthejë

shumën prej 16,074.02 € të paguar më tepër si rezultat i rivlerësimit të mallit në DUD-in kontestues 24090/28.07.2020, së bashku me kamatën prej 8 % nga data kur mjetet janë paguar si rezultat i rivlerësimit, e deri në nxjerrjen e këtij aktgjykimi. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 03.03.2021 e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Aktvendimi i atakuar është marr komfor të të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i kontestuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se e paditura e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Mbesim në tërësi pranë aktvendimit të kontestuar 01.3.2.2/9300/2020, të datës 27.08.2020. Konsiderojmë se vendimi i atakuar është marrë në tërësi konform rregullativave ligjore në fuqi. Po ashtu, pretendimet e palës paditëse se aktvendimi është marrë me shkelje ligjore nuk qëndrojnë, dhe këto pretendime pala paditëse nuk i ka vërtetuar me asnjë provë. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, ka administruar provat dhe atë: Aktvendimi 01.3.2.2/9300/2020, i datës 27.08.2020, DUD-i nr. ..., Pro Fatura nr. ..., Transaksionet Bankare Ndërkombëtare të bankës TEB të datës 22.07.2020, Fatura Tatimore nr. ..., Deklaratat T2 e datës 27.07.2020, Packing List e datës 22.06.2020, Fatura nr. ..., Deklarata DV1 e datës 28.07.2020, Përgjigja në Padi e datës 03.03.2021, Ankesa e ushtruar në Doganën e Kosovës nr.9300/04.08.2020, Procesi mbi Përcaktimin e Vlerës së Mallrave i datës 28.07.2020, Pro Faturat e datës 22.05.2020, 25.05.2020, 21.05.2020, 23.05.2020.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi dhe seancë, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, të Ligjit për Procedurën

Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga DUD-i kontestues i Doganës së Kosovës, deklarimeve në padi, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestues fakti se paditësi ka paraqitur DUD-in R- ... për zhdoganim pranë Zyrës Doganore Prizren, me ç 'rast i njëjti është proceduar, duke u ri-vlerësuar bazuar në metodën e 6-të. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi, ka ushtruar ankesë pranë Doganës së Kosovës, e për të cilën ankesë, Dogana e Kosovës me datë 27.08.2020, ka sjell Aktvendimin nr. 01.3.2.2/9300 si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin është refuzuar kërkesat e subjekti në procedurë, e kundër të cilit, paditësi me padinë e datës 30.09.2020, ka iniciuar konfliktin administrativ pranë kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës në shkallë të dytë e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë këtu paditësit, për rishqyrtimin e deklaratës unike doganore DUD-it R-... . E paditura ka vlerësuar se Sektori i pranimit qendror ka vepruar drejtë kur e ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është çmim real i paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Tutje theksohet se dokumentacioni përcjellës i mallrave lëndor kontestues është konsideruar i pamjaftueshëm, pasi që çmimet janë dukshëm më të ulëta në krahasim me vlerën reale të mallit, andaj Dogana ka caktuar vlerë të re doganore bazuar në të dhënat e disponueshme.

Gjykata nga aktvendimi kontestues vëren se ai përmban të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, te metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit kontestuese përmban të dhëna të pamjaftueshme dhe jo të plota sa i përket rivlerësimit të mallit lëndor. Në arsyetimin kontestues nuk është dhënë arsyetim i bazuar, përse nuk është pranuar vlera e transaksionit, kur paditësi ka prezantuar dokumentacionin valid që dëshmon për çmimin e paguar, dhe nuk është dhënë asnjë provë për tu dëshmuar se paditësi i ka paguar eksportuesit mbi çmimin e

faturës së mallit, për të dëshmuar konstatimin e dhënë se vlerës së mallit të deklaruar për zhdoganim nuk duhet t'i pranohet vlera e transaksionit.

Mos vërtetimi i plotë i gjendjes faktike, Gjykata e konsideron faktin se vendimi i kontestuar nuk përmban arsye për faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike-administrative. Në arsyetim të vendimit kontestues, thuhet se Sektori e Pranimit Qendror ka vepruar drejt kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlera reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë, për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport, përkatësisht për import në vendin tonë, në vështrim të nenit 33, të KDA-së, mirëpo një konstatim i tillë për Gjykatën është tërësisht i pa qëndrueshëm dhe i pa mbështetur në prova materiale, është shumë kontradiktor në vetvete dhe në raport me dokumentacionin e prezantuar, si dhe me bazën ligjore në fuqi, dhe sepse e paditura nuk ka qenë të gjendje të provojë këtë konstatim, kjo edhe përmes ndonjë dëshmie me të cilin do të argumentohet se paditësi, nuk i ka paguar eksportuesit përmes transaksionit bankar çmimin e faturës apo se i ka paguar eksportuesit mbi çmimin e faturës blerëse të mallit.

Gjykata ka shqyrtuar vendimin kontestuese dhe pretendimet e paditësit lidhur me mospranimin e vlerës së mallit, duke konstatuar se paditësi, ka provuar që me prova bindëse të dëshmoj para Doganës që në kuptim të dokumenteve përcjellëse të prezantuara, paditësi në këtë rast ka prezantuar urdhërpagesat bankare ndërkombëtare të datës 28.05.2020 në vlerë prej 10,897.00 USD dhe 09.07.2020 në vlerë prej 25,200.00 USD përmes të cilave është paguar pro-fatura nr. A20200521V dhe fatura me të njëjtin numër e të cilat janë të harmonizuara në tërësi në kuptim të vlerës dhe të përshkrimit me transaksionet bankare. Gjykata vlerëson se legjislacioni doganor nuk përmban dispozita ku thuhet se vlera doganore e mallrave të importuara, duhet të jetë në përputhje me vlerën e të dhënave të disponueshme nga Dogana e Kosovës, në rastet kur ka dokumentacion përcjellës të harmonizuar, por përkundrazi tek neni 33 par.1 të KDA-së është parashikuar se *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37”*.

Gjykata e obligon të paditurën se në rishqyrtim dhe rivendosje, duhet të konstatojë këto pretendime të cekura si më lartë dhe argumentet e paditësit dhe të deklarohet lidhur me provat e administruara përkatësisht urdhërpagesat bankare ndërkombëtare të datës 28.05.2020 në vlerë prej 10,897.00 USD dhe 09.07.2020 në vlerë prej 25,200.00 USD përmes të cilave është paguar pro-fatura nr. A20200521V dhe fatura me të njëjtin numër. Në arsyetimin e vendimit kontestues shihet se e paditura nuk ka shqyrtuar drejtë pretendimet e paditësit për të konstatuar se fatura dhe dokumentet tjera përcjellëse, përse janë kontestuar, pra nuk janë marr për bazë dhe nuk i kanë pranuar si valide, andaj një akt administrativ i tillë nuk përmban një përmbledhje të konstatimeve faktike bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata. Tutje e paditura nuk është deklaruar fare lidhur me provat në të cilat është bazuar respektivisht në të dhënat e disponueshme siç është referuar. E paditura të dhënat lidhur me rivlerësimin vetëm i ka përmendur në arsyetim të vendimit kontestues si të dhëna nga dosja e vlerës duke theksuar se të njëjtat janë të cekura në procesin mbi përcaktimin e vlerës së mallrave derisa në këtë proces, pra në procesin mbi përcaktimin e vlerës së mallrave të datës 28.07.2020, thuhet se rivlerësimi është bërë sipas veb faqes [....](#) gjë që qartë arsyetimi i aktvendimit kontestues bie në kundërtënie lidhur me provat e referuara. Për më tepër e paditura nuk ka bashkëngjitur asnjë të dhënë referuese nga dosja e vlerës sikurse as ndonjë faqe nga [....](#), pra nuk dihet se si e paditura ka ardhur deri tek rivlerësimi i mallit lëndor sipas DUD-it kontestues R- ..., fakt këtë të cilin duhet ta eliminojë gjatë shqyrtimit të lëndës në ri procedurë-rivendosje.

Të metat e mësipërme janë të asaj natyre që e bëjnë të pa mundur vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj aktvendimi i atakuar u deshtë që doemos të anulohet, tutje Gjykata e obligon të paditurën që në ri procedurë të deklarohet lidhur me provat e paraqitura nga paditësi lidhur me deklaratën unike doganore R-24090/28.07.2020, dhe të administruar nga Gjykata e të cilat u përmenden më lartë.

Me rastin e nxjerrjes së vendimit të ri, e paditura të vlerësojë drejt gjendjen faktike që rezulton nga dokumentacioni i mallit të deklarohet lidhur me të dhënat e aplikuara me rastin e rivlerësimit të mallit kontestues dhe të aplikoj drejt dispozitat ligjore me të cilën përcaktohet vlerësimi i mallrave. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon padinë e paditësit, anulon aktvendimin e kontestuar, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 par.2 të LKA-së e detyron të paditurën, që në ri procedurë të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetimin të këtij aktgjykimi.

Vendimi që secila palë t'i bart shpenzimet e veta procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 43, par 2, e 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.66/22 datë 26.09.2022

Bashkëpunatori Profesional

Visar GASHI

Gj y q t a r i,

Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.